

MINISTRIA E MBROJTJES

I. TË DHËNAT PËR POZITËN E PUNËS

Emërtesa e pozitës: *Operator i Makinës për Inspektim Vizual*

Institucioni: *Ministria e Mbrojtjes*

Kategoria; Nivel Profesional

Klasa; *Profesional 3*

Raporton tek: Mbikëqyrësit e Linjës së Prodhimit të Kutive

Grada/paga: 1020€

II. MISIONI

Projekti synon funksionalizimin e Fabrikës së Municionit të Republikës së Kosovës, në Gjakovë, në përputhje me detyrimet e kontratës për ndërtimin e fabrikës. Projekti parashikohet të realizohet brenda periudhës korrik–dhjetor 2026 nën mbikëqyrje drektë nga Ministri i Mbrojtjes.

III. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZITËS SË PUNËS

Qëllimi i këtij projekti është të sigurojë drejtimit e nevojshme për funksionalizimin e fabrikës në përputhje me kushtet e kontratës, si dhe të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve vendore prodhuese dhe rritjen e sigurisë së furnizimit.

IV. DETYRAT KRYESORE

- Kryen inspektim vizual/automatik final të gëzhojave sipas kritereve të miratuara.
- Ndan produktin e konformuar nga ai jo-konform sipas procedurës së klasifikimit.
- Dokumenton rezultatet e inspektimit dhe përqindjen e refuzimeve për çdo turn.
- Njofton Inxhinierin e Kontrollit të Cilësisë në rast trendi të rritur të jo-konformiteteve.

V. PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. Planifikimin dhe objektivat (nëse ka)

A.1. NA

B. Menaxhimin (nëse ka)

B.1. NA

C. Detyrat teknike

C.1 Franon dhe konsolidon kërkesat e reja për programe nga MM/FSK për t'i dorëzuar për shqyrtim.

C.2 Përgatit raportet sipas nevojave dhe raporton rregullisht të mbikëqyrësi i linjës;

C.3 Kryen detyra tjera të dhëna nga mbikëqyrësi i linjës.

D. Përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin

D.1. NA

VI. RËNDËSIA

Funksionalizimi i Fabrikës së Municionit përbën një investim strategjik për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të Republikës së Kosovës, forcimin e industrisë vendore të mbrojtjes dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me municion.

VII. LIRIA NË VENDIMMARRJE

Liria në vendimmarrje përfshin punën nën mbikëqyrje të zakonshme, jo të rregullt për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme dhe specifike të eprorit/mbikëqyrësit.

VIII. VËSHTIRËSIA

Niveli i vështirësisë – përfshin, procese pune që paraqesin kompleksitet të mesëm dhe nevojë të moderuar për inovacion.

IX. MBIKËQYRJA

Operatori mbikëqyret nga Mbikëqyrësit e Linjës së Prodhimit të Kutive.

X. STAFI NËN VARËSI (nëse ka)

NA

XI. KUSHTET E PUNËS

- Orari i punës është i plotë;
- Njohuri pune në formimin e metaleve.
- Njohuri në leximin e vizatimeve teknike,
- Aftësi në përdorimin e mjeteve dhe matësve,
- Aftësi në makina të kontrolluara nga PLC.
- Kontrata e punës hyn në fuqi vetëm pasi kandidati të ketë përfunduar me sukses procesin e trajnimit, i cili do të zhvillohet në Turqi.
- Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

I. **KËRKESAT E PËRGJITHSHME FORMALE DHE SPECIFIK** (Kategoria, Klasa, Grupi, përvoja ne pune dhe kërkesat tjera specifike)

- **Kategoria dhe klasa e pozitës; Profesional 3**
Grupi dhe fusha e kërkuar e arsimit; Grupi i administrimit te përgjithshëm; Arsim i mesëm i paspecifikuar.
- **Përvoja e punës:** nuk kërkohet
- Njohja e gjuhës shqipe ose serbe,
- **Kërkesat specifike;**

XIII – NËNSHKRIMI

1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: _____

2. Udhëheqësi më i lartë administrativ: _____

